



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË INDUSTRIJË
DHE ENERGJISË

Nr. 4955
3 prot.

Tiranë, më 24.3.2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1807, datë 27.06.2016.

SHOQËRISË "HEKO KONSTRUKSION" SH.P.K
Rruga nacionale "Fier - Patos", kilometri 4, Portëz, Fier.

Për dijëni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi "Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA (AKSEM), ISH RISHM
Rruga "Lord Bajron", Laprakë, Tiranë.

Shoqëria juaj "Heko Konstruksion" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1807, datë 27.06.2016, për mineral gur gëlqeror, në objektin "Klos", në Qarkun Fier.

Me kërkesën tuaj datë 12.07.2017, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë me nr.4955, datë 12.07.2017 kërkon mbylljen e aktivitetit minerar, pasi keni problem me banorët e zonës, me të cilët nuk keni arritur mirëkuptimin dhe nuk ju lejojnë të punoni në objekt. Kjo kërkesë i është përcjellë strukturës përgjegjëse, Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), për të bërë verifikimet e propozimit përkatës, në përputhje me nenin 43, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së, me shkresën nr.5988/1, datë 21.08.2017, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr. 4955/1, datë 22.08.2017, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.1807, datë 27.06.2016, për mineral gur gëlqeror, në objektin "Klos", në Qarkun Fier.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, për revokim, është i mbështetur në gërmën "a", të pikës 2, të nenit 47, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar ku thuhet se: "*me kërkesën e zotëruesit, kur ai i ka plotësuar të gjitha detyrimet e lejes minerare*".

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1807, datë

27.06.2016, për mineral gur gëlqeror, në objektin "Klos", në Qarkun Fier. që shoqëria juaj zotëron.

Ju vëmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1807, datë 27.06.2016, për mineral gur gëlqeror, në objektin "Klos", në Qarkun Fier.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitetet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI
DAMIAN GJIKNURI

NË MUNGESË DHE ME POROSI

ZËVENDËSMINISTRI

ENIS ALIKO

